



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2022

V E N D I M

Nr. 51, datë 10/03/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 168, datë 20.09.2021, e Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive, znj. S.L., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankesa konsiston në evidentimin e një sërë problematikash të hasura gjatë eventit muzikor të zhvilluar në Tiranë, në datën 17.09.2021, në stadiumin “Air Albania”. Pretendimi për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar drejtohet ndaj subjekteve të sipërcituar, në cilësinë e organizatorëve të këtij koncerti.

Znj. S.L. sqaron në ankesë se në datën 08.09.2021 ka patur akses në platformën *on line* për rezervimin e biletës¹, për të marrë pjesë si spektatore në koncertin e sipërcituar. Ankuesja sqaron se ka kryer kërkim *on line* për t’u informuar mbi kushtet e aksesueshmërisë fizike, në këtë stadium, për personat me aftësi të kufizuar. Ajo pretendon se stadiumi “Air Albania” nuk ka faqe *on line* dhe si pasojë nuk ka qenë e mundur që znj. S.L. të marrë informacion mbi aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar në të, si dhe për tribunat, ku mund të ndodheshin vende të përshtatshme për këta persona.

Ankuesja sqaron se ka prenotuar biletë në Tribunën E dhe në prenotim ka vënë shënimin “person me aftësi të kufizuara”. Në vijim, kanë ardhur e-maile mbi orarin e zhvillimit të koncertit, por asnjë informacion mbi biletën dhe mbi të dhënat që ajo kishte shënuar, mbi aftësinë e saj të kufizuar.

¹ Sipas informacionit të administruar prenotimi *on line* ishte i detyrueshëm edhe pse në koncert aksesimi ishte pa pagesë;

Në datën 17.09.2021, znj. S.L. është paraqitur në hyrjen kryesore të Stadiumit “Air Albania”, ku është informuar nga punonjësi përgjegjës se ajo nuk mund të hynte në koncert, pasi Tribuna E nuk kishte ashensor dhe nëse do të duhej të kishte akses në këtë tribunë, ajo duhet të transportohej fizikisht nga persona të tjerë. Znj. S.L. u informua se aksesimi me ashensor mund të kryhej vetëm në tribunat anësore të stadiumit, ndërkohë që nuk iu dha mundësia të ndërronte biletë për të patur akses në këto tribuna.

Në vijim, znj. S.L. shprehet se është ndihmuar nga punonjësit e Policisë Bashkiake, të cilët e kanë transportuar fizikisht, në mënyrë që ajo të kishte akses në ambientet e tribunës E 107 dhe se ky moment është filmuar nga njëri prej punonjësve të Policisë Bashkiake. Ankuesja shprehet se brenda në stadium nuk kishte vende të dedikuara për personat me aftësi të kufizuar, ndaj në këto kushte ajo është pozicionuar në korridor, tek pjesa mbi ndenjset.

Pas përfundimit të koncertit, znj. S.L. sqaron se është drejtuar për tek ashensori i tribunës anësore S1, i cili rezultoi të ishte jashtë shërbimit. Ajo shprehet se ka kërkuar stafin përgjegjës në të gjithë ambientet e stadiumit, por ka qenë e pamundur. Në vijim, ajo sqaron se ka kontaktuar me rojen e stadiumit, i cili është lidhur me eprorin e tij dhe me Policinë Bashkiake për të gjetur një zgjidhje, por sërish nuk ka patur rezultat për të siguruar akses fizik normal për znj. S.L.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 168, datë 20.09.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Tiranë, Federatës Shqiptare të Futbollit, si dhe për dijeni Ambasadës Italiane dhe subjektit ankues, me shkresën nr. 1321/1, datë 24.09.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

1. Informacion mbi mënyrën se si sigurohet aksesueshmëria fizike e personave me aftësi të kufizuar (para-tetraplegjikë) në Stadiumin “Air Albania”. Informacion nëse ka rampa dhe ashensorë në ambientet dhe tribunat e këtij stadiumi, që sigurojnë aksesueshmërinë fizike të kësaj kategorie personash me aftësi të kufizuar. A ka vende të posaçme për akomodimin e personave me aftësi të kufizuar në këtë stadium? A ka staf përgjegjës gjatë zhvillimit të aktiviteteve në këtë stadium, që zgjidhin problematika të natyrës së sipërcituar?
 2. A ka patur seksione të veçanta, në plaformën *on line*, që u përdor për prentim biletash, për koncertin e këngëtarit E. M., që kanë ofruar informacion për personat me aftësi të kufizuara?
 3. Informacion nëse organizatorët e këtij koncerti kanë marrë informacion paraprak nga FSHF, mbi faktin nëse Stadiumi “Air Albania” ofron akses fizik për personat me aftësi të kufizuar, në datën 17.09.2021, të cilët mund të ishin në cilësinë e spektatorit në këtë event?
 4. A ka patur staf të veçantë dhe udhëzime nga organizatorët e eventit të sipërcituar, për orientimin dhe udhëzimin e personave me aftësi të kufizuar, në datën 17.09.2021?
 5. Informacion mbi ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive të organizatorëve të eventit të datës 17.09.2021. Të përcillet akti administrativ, që përmban këtë ndarje detyrash dhe përgjegjësish ndërmjet tyre
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, Federata Shqiptare e Futbollit⁴ dërgoi shkresën nr. 1832 prot., datë 06.10.2021, nëpërmjet së cilës informon se kësaj Federate i është kërkuar prej organizatorëve të koncertit të këngëtarit Ermal Meta, vendosja në dispozicion pa pagesë e stadiumit “Air Albania”, kërkesë, e cila është pranuar nga FSHF, përmes operatorit të stadiumit, përkatësisht Shoqërisë Qendra Sportive Kuq e Zi sh.p.k.

Stadiumi “Air Albania” është një stadium i Kategorisë 4, sipas klasifikimit të UEFA-s dhe ka vende të dedikuara për spektatorët me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre. Këto vende kanë akses të posaçëm (ashensorë dhe/ose rampa) dhe tualete të dedikuara në përputhje me rregulloren e infrastrukturës së stadimeve të UEFA-s. Konkretisht, pozicionet e dedikuara për spektatorë me aftësi të kufizuara, në Stadiumin “Air Albania” ndodhen në sektorin “S” (Tribuna Jugore) dhe “N” (Tribuna Veriore). Për orientim, bashkëlidhur shkresës është dërguar një skicë e Stadiumit.

FSHF sqaron gjithashtu se sikurse për eventet e tjera, futbollistike, edhe për këtë event, biletat kanë qenë të aksesueshme përmes faqes *on line* të FSHF-së, përkatësisht në www.fshf.org, seksioni “Biletaria Online”. Në këtë seksion, çelet një faqe tjetër e nënkontraktorit të FSHF-së me qëllim blerjen apo informimin mbi biletat *on line* dhe ku mund të vihet re edhe guida e blerjes, në të cilën specifikohen të gjitha informacionet e nevojshme për blerjen e biletave në

⁴ Në vijim do t'i referohemi me akronimin FSHF.

web. Në guidën e sipërpërmendur, e cila është dërguar bashkëlidhur shkresës, shpjegohet vendndodhja e vendeve për personat me aftësi ndryshe dhe mënyra e marrjes së biletave.

Në lidhje me çështjet e tjera të parashtruara nga KMD, në masën që ato nuk kanë marrë përgjigje, FSHF sqaron se nuk ka patur staf të dedikuar për këtë event, pasi nuk ka qenë organizatore e tij.

FSHF shpreh keqardhje për sa dyshohet se ka ndodhur dhe sqaron se është hera e parë që një ngjarje e tillë silltet në vëmendjen e saj. Kjo Federatë vë në dukje faktin se historikisht, personave me aftësi të kufizuara, u është siguruar akses pa pagesë në garat e FSHF-së dhe se incidenti në fjalë mund të jetë thjesht rezultat i një mungese paraprake informacioni dhe kurrsesi pasojë e një diskriminimi. Në shkresë theksohet fakti se FSHF mbetet e angazhuar për të promovuar vlerat e etikës, mosdiskriminimit dhe barazisë, vlera, të cilat i ka inkorporuar edhe në Statutin e saj. Projektet e FSHF-së për financimin e ekipit kombëtar të të amputuarve reflektojnë posaçërisht për këto vlera, në kuadër të përgjegjësisë sociale, marrëdhënieve miqësore dhe gjithpërfshirjes.

- Bashkia Tiranë nuk i ktheu përgjigje shkresës së KMD-së.
- Në këto kushte, në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 25.11.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.
- Me kërkesë të Bashkisë Tiranë, të dërguar me e-mail, seanca dëgjimore u shty për një datë të mëvonshme.
- Në vijim, Bashkia Tiranë dërgoi përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 44579/1 prot., datë 25.11.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se koncerti i këngëtarit E. M. është zhvilluar në datën 17.09.2021, në stadiumin “Air Albania” dhe është një organizim i përbashkët, si rrjedhim i iniciativës së Ambasadës Italiane në Shqipëri, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Bashkisë Tiranë. Ky koncert është organizuar në kuadër të 30 vjetorit të zbrakimit të anijes së parë me emigrantë shqiptarë në Itali dhe synoi të sjellë vëmendjen në marrëdhënien e bashkëpunimit të vecantë ndërmjet dy vendeve tona. Artisti me origjinë shqiptare E. M., fitues i çmimeve prestigjioze në festival ndërkombëtare u përzgjedh prej Ambasadës Italiane në Shqipëri si shembulli më i mirë i suksesit.

Bashkia Tiranë sqaron se Stadiumi “Air Albania” është një projekt modern i projektuar nga arkitekti italian Marco Casamonti dhe është ndërtuar sipas standardeve moderne ndërkombëtare. Ky stadium është i certifikuar nga institucionet përgjegjëse dhe siguron akses për personat me aftësi të kufizuara. Ky ishte një faktor i rëndësishëm që u mor parasysh në përzgjedhjen e kësaj hapësire për zhvillimin e koncertit, sikurse edhe fakti se ky stadium siguron mundësinë për një kapacitet të konsiderueshëm të audiencës, në përputhje me Rregulloret Anticovid, si dhe duke respektuar rregullat e distancimit social. Respektimi i këtyre masave solli nevojshmërinë e rezervimit të biletave on line, edhe pse pa pagesë.

Bashkia Tiranë nënvizon faktin se menaxhimi i sistemit të biletarisë dhe stadiumit “Air Albania” është përgjegjësi e Federatës Shqiptare të Futbollit dhe jo e Bashkisë Tiranë. Për këtë arsye është jashtë fushës së përgjegjësive së Bashkisë Tiranë dhënia e një përgjigjeje specifike, lidhur me kërkesën e KMD-së. Po kështu, një kompani sigurie private, e kontraktuar nga vetë struktura menaxhuese e stadiumit ishte përgjegjëse për menaxhimin e hapësirave të brendshme të tij. Ndërkohë që, Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit kanë patur rol mbështetës në funksion të ruajtjes së rendit dhe sigurisë së audiencës. Bashkia e Tiranës vendosi në dispozicion të tyre një grup prej 100 vullnetarësh, të cilët u instruktuan nga grupi drejtues i stadiumit.

Për sa më sipër, Bashkia Tiranë thekson faktin se e mirëkupton shqetësimin e Komisionerit dhe kërkon ndjesë për incidentin e krijuar, i cili shkon ndesh me principet e këtij institucioni dhe punën që bën çdo ditë për të ndërtuar një qytet që ofron mundësi të barabarta për të gjithë. Bashkia Tiranë e informon KMD se në koncert janë akomoduar persona me aftësi të kufizuara, si në pjesën e sipërme të tribunës, ashtu edhe në pjesën e poshtme pranë skenës. Po kështu, Bashkia Tiranë sqaron se ka mirëpritur kërkesa për të organizuar takime me këngëtarin, si dhe për të akomoduar persona me aftësi të kufizuara, të cilët kanë kontaktuar paraprakisht nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit.

- Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 16.12.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në këtë seancë dëgjimore mori pjesë znj. A.S., përfaqësuese e Fondacionit Së Bashku dhe z. K.T., përfaqësues i Bashkisë Tiranë. Federata Shqiptare e Futbollit nuk dërgoi përfaqësues në këtë seancë dëgjimore.

Përfaqësuesja e subjektit ankesës parashtrroi edhe një herë pretendimet e saj për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit. Znj. S.L. u pajis me biletë nëpërmjet sistemit on line. Pavarësisht se eventin ishte falas, sërisht pajisja me biletë ishte e nevojshme. Znj. S.L. është tetraplegjike dhe e bën aksesimin e kompjuterit nëpërmjet zërit. Kur klikohej në sistemin e biletave, në asnjë rast nuk evidentohej se cilat ishin vendet e disponueshme për personat me aftësi të kufizuara. Në këto kushte, znj. S.L. shënoi në kutinë përkatëse të sistemit on line që ishte person me aftësi të kufizuara dhe kishte nevojë për një vend të dedikuar kësaj kategorie personash. Në ditën e eventit, tek dera e stadiumit ndodheshin përfaqësues të Policisë Bashkiake dhe Bashkisë Tiranë dhe përgjegjësi i stadiumit. Në vijim, znj. S.L. u vu në dijeni të faktit se stadiumi kishte disa hyrje, por vetëm në dy prej tyre sigurohej aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ashensorit. U komunikua me përgjegjësin e stadiumit që qendronte pranë hyrjes së stadiumit dhe iu kërkua që të ndërroheshin vendet e prenotuara nga tribuna, në një nga pjesët e stadiumit, ku aksesimi bëhej nëpërmjet ashensorit. Ai refuzoi duke sqaruar se nëse nuk disponin biletë, ashensori nuk mund të hapej. Zgjidhja e dhënë nga ana e tij ishte që grupi i personave që shoqëronin znj. S.L. të qendronte dhe ta ndiqte eventin jashtë stadiumit. Në këtë çast, ndërhyu Policia Bashkiake, e cila e transportoi fizikisht znj. S.L. në katin e parë të stadiumit dhe në vijim njëri prej kontrollorëve i ka këshilluar të qëndronin në sheshpushimin e katit të parë, përfaqësuesja e Fondacionit Së bashku sqaron se në përfundim të koncertit rreth tyre nuk

ndodhej asnjë përfaqësues i Policisë Bashkiake dhe as nga stafi përkatës i Stadiumit, për ta ndihmuar znj. S.L. për të dalë prej tij. Vendi ku ndodhej ankuesja ishte shumë pranë ashensorit të stadiumit, por Suelës nuk iu dha akses për të përdorur atë. Disa qytetarë në rastit e ndihmuar znj. S.L. duke e transportuar fizikisht atë në dalje të hyrjes së stadiumit. Përfaqësuesja e ankueses shprehet se disa prej policëve bashkiakë e kanë filmuar momentin e transportimit fizik të Suela Lalës, porse pala ankuese nuk disponon emrat e tyre dhe në këto kushte nuk disponon filmimin në cilësi provë.

Në vijim, përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë sqaroi se çështja u është bërë e ditur nga KMD. Ai u fokusua tek dy çështje që i konsideron të rëndësishme. E para konsiston në mosvënien e informacionit *on line* mbi aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar dhe e dyta konsiston në mospasjen e aksesit për t'u ulur në vendet përkatëse në stadium.

Iniciativa për organizimin e këtij koncerti ka qenë e Ambasadës italiane, e cila ka dërguar një marrëveshje, ku ndaheshin detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në këtë event. Kjo marrëveshje është dërguar me email në datën 28.08.2021. Pjesa e biletarisë dhe e akomodimit në stadium ka qenë detyrë e Federatës Shqiptare të Futbollit. Në nenin 24, të Rregullores së Infrastrukturës të miratuar nga ana e Komitetit Ekzekutiv të FSHF-së parashikohen edhe çështjet lidhur me aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuara.

Asnjë nga problematikat e parashtruara nga znj. S.L. nuk bën pjesë në pikat e marrëveshjes së mësipërme që bëjnë pjesë në detyrat dhe përgjegjësitë e Bashkisë Tiranë. Përfaqësuesi i bashkisë Tiranë sqaroi se ka një komunikim informal ndërmjet institucioneve, ku FSHF ka patur nevojë për vullnetarë dhe 100 të tillë janë dërguar nga Bashkia Tiranë.

Përfaqësuesit e KMD-së vunë në dukje faktin se edhe pse kjo marrëveshje është kërkuar zyrtarisht nga KMD, nuk është dërguar nga ana e Bashkisë Tiranë. Përfaqësuesi i këtij institucioni kërkoi të dispononte një kopje të shkresës së KMD-së në mënyrë që marrëveshja të dërgohej në vijim.

- Në vijim të seancës degjimore, KMD iu drejtua Bashkisë së Tiranës, në datën 06.01.2022, nëpërmjet e-mailit zyrtar, ku kërkon një kopje të Marrëveshjes së dërguar nga ana e Ambasadës Italiane në adresë të Bashkisë Tiranë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit. Njëkohësisht nëpërmjet këtij emaili dërgohen edhe disa shkresa dhe procesverbali i seancës degjimore të datës 16.12.2021.
- Në vijim të e-mailit të KMD-së, Bashkia e Tiranës dërgoi e-mailin e datës 07.01.2022, nëpërmjet së cilit dërgon marrëveshjen e kërkuar.
- Nëpërmjet shkresës nr. 266 prot., datë 07.07.2022, Komisioneri iu drejtuar Federatës Shqiptare të Futbollit, ku kërkoi informacion mbi mënyrën se si është proceduar për përmbushjen e detyrimeve të caktuara në Marrëveshjen e dërguar nga Ambasada Italiane, duke i lidhur me pretendimet e subjektit ankues. FSHF-së iu kërkua që informacioni i dërguar brenda 5 ditëve nga marrja dijeni mbi shkresën e sipërcituar.

- FSHF nuk i dërgoi përgjigje shkresës së sipërcituar të KMD-së.
- Në vijim, KMD iu drejtua sërish ankueses S.L. duke i kërkuar të depozitojë çdo prove tjetër që disponon për të vërtetuar pretendimet e saj kundër Bashkisë Tiranë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit.
- Në përgjigje të emailit të KMD-së, ankuesja u përgjigj se: *“Unë po ju dërgoj biletën elektronike, por siç u ankuam, sistemi online i rezervimit të biletës dhe gjithashtu bileta nuk kishte asnjë specifikim për vendet e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Pra pyetja që duhet të bëni ka të bëjë me sistemin online të rezervimit të biletave. Gjithashtu në godinë nuk ka asnjë sinjalistikë për rrugët e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.”*

A. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Pretendimi i znj. S.L. kundër Bashkisë Tiranë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me dy momente, ku i pari konsiston në mosdhënien e informacionit të nevojshëm në faqen zyrtare të FSHF-së, gjatë procesit të blerjes së biletave *on line*, mbi tribinat dhe vendet respektive për personat me aftësi të kufizuara, në koncertin e këngëtarit Ermal Meta, si dhe dhe mos sigurimin e aksesueshmërisë fizike të ankueses, e cila i përket kategorisë së personave para-tetraplegjike, në stadiumin “Air Albania”, gjatë këtij eventit muzikor.

Fillimisht, KMD u fokusua tek ndarja e përgjegjësisë dhe detyrave ndërmjet institucioneve organizatore të këtij eventit. Në këtë kontekst, Komisioneri i është referuar shkresës nr. 2245, datë 30.07.2021, të Ambasadës Italiane, drejtuar Presidentit të FSHF-së ose së njëjtës shkresë nr. 2498, datë 23.08.2021 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nëpërmjet së cilës rregullohen përgjegjësitë e institucioneve, lidhur me eventin e organizuar. Shkresat konsistojnë në një marrëveshje të nënshkruar nga titullarët e sipërcituar, nëpërmjet së cilës marrin përsipër disa detyrime për zhvillimin e koncertit.

Në nenin 4 të kësaj marrëveshjeje parashikohen angazhimet e Ambasadës Italiane dhe Bashkisë Tiranë. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se:

“Neni 4 – Angazhimet e Ambasadës dhe Bashkisë Tiranë

Përsa i përket Ambasadës dhe Bashkisë Tiranë, ato angazhohen, falë mbështetjes së disa sponsorve komercialë dhe deri në një maksimum prej 150,000 euro, për të:

- 1. Mbuluar tarifat e muzikantëve dhe tarifat e teknikëve;*
- 2. Financuar shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit të artistëve dhe teknikëve;*
- 3. Financuar shpenzimet e vendosjes dhe çmontimit të skenës, sistemit fonik dhe sistemit të ndriçimit;*
- 4. Siguruar shërbimin e sigurisë për koncertin dhe për ditët nga 11 deri më 19 shtator 2021 gjithashtu edhe me qëllim garantimin e sigurisë së operacioneve të vendosjes dhe çmontimit të skenës dhe pajisjeve.”*

Për sa më sipër, në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje parashikohen angazhimet e FSHF-së. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se:

“FSHF-ja angazhohet të:

- 1. Vendosë në dispozicion stadiumin “Air Albania” , pa asnjë tarifë, për të paktën shtatë ditë të plota duke filluar nga data 11 dhe deri më 19 shtator 2021 (të nevojshme për ngritjen e skenës, koncertin dhe çmontimin e skenës);*
- 2. Marrë përsipër çdo kosto në lidhje me restaurimin e fushës së stadiumit dhe çdo dëmtim të shkaktuar nga publiku pa kërkuar asgjë nga Ambasada, Bashkia e Tiranës, shoqëria e shërbimit apo nga kompania e prodhimit të muzikës Mescal.*
- 3. Sigurojë shërbimin teknik të biletarisë pa asnjë pagesë; Ofrim i shërbimit të kontrollit dhe hyrjes si dhe të asistentëve të publikut dhe të sigurisë brenda stadiumit gjatë koncertit dhe shërbimin e pastrimit në fund të koncertit.”*

Në këtë marrëveshje, ekzistojnë edhe disa nene të tjera që përcaktojnë angazhimet e kompanisë së prodhimit të muzikës Mescal (neni 5) dhe angazhimet e shoqërisë së shërbimit përgjegjëse për çmontimin (neni 6), të cilat kanë kryesisht përgjegjësi të natyrës teknike.

Nga parashikimet e mësipërme, rezulton se shërbimi i biletarisë *on line* dhe shërbimi i kontrollit dhe hyrjes në stadium, si dhe të asistentëve të publikut dhe të sigurisë brenda stadiumit janë detyra dhe përgjegjësi të FSHF-së, në kuadër të eventit të organizuar. Pavarësisht se eventit mbante logon e Bashkisë Tiranë dhe Ambasadës Italianë në Shqipëri, problematikat e pretenduara nga pala ankuese kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me përgjegjësitë e FSHF-së, të caktuara në marrëveshjen e sipërcituar.

KMD fillimisht u fokusua dhe i kushtoi rëndësi faktin nëse Stadiumi “Air Albania” i plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me këtë problematikë, KMD u mbështet në të dhënat e dërguara nga FSHF gjatë korrespondencës zyrtare me KMD-në. Fotot dhe skicat e dërguara nga FSHF vërtetonin që ky stadium i përmbush këto kushte, pasi është një stadium i Kategorisë 4, sipas klasifikimit të UEFA-s dhe ka vende të dedikuara për spektatorët me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre. Këto vende kanë akses të posaçëm (ashensorë dhe/ose rampa) dhe tualete të dedikuara në përputhje me rregulloren e infrastrukturës së stadiumeve të UEFA-s. Konkretisht, pozicionet e dedikuara

për spektatorë me aftësi të kufizuara, në Stadiumin “Air Albania” ndodhen në sektorin “S” (Tribuna Jugore) dhe “N” (Tribuna Veriore). KMD kreu verifikime edhe ne faqen *on line* të FSHF-së, ku ndodhen të publikuara të dhëna specifike mbi stadiumin dhe infrastrukturën e tij.

Përveç sa më sipër, KMD u mbështet edhe në analizimin e Rregullores së Infrastrukturës së Stadiumit “Air Albania” (2019), ku në nenin 24 të saj, parashikohet se:

“Neni 24

Ambientet për spektatorët me aftësi të kufizuara

24.1 Stadiumet duhet të kenë akses të dedikuar, rrugë dalëse dhe ulëse të dedikuara për spektatorët me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre. Të gjitha këto vende duhet të ofrojnë një pamje të lirë të fushës së lojës.

24.2 Stadiumet duhet të kenë ambiente të aksesueshme sanitare të dedikuara në sektorët ku ndodhen vendet për spektatorë me aftësi të kufizuara.

24.3 Duhet të vendoset në dispozicion një tualet për persona me aftësi të kufizuara për çdo 15 spektatorë me aftësi të kufizuara.”

Për sa më sipër, KMD konstatoi se Stadiumi “Air Albania” i përmbush kushtet për sigurimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuara.

Për të kryer verifikime lidhur me pretendimin e ankueses se nuk ka informacione udhëzuese mbi personat me aftësi të kufizuar, në stadiumin “Air Albania”, KMD fillimisht aksesoi në mënyrë të drejtpërdrejtë linkun e dërguar nga ankuesja⁵, përkatësisht në faqen BliniBileta.com. Gjatë kërkimit në këtë faqe, KMD konstatoi se në të ndodhej rubrika Guida e Blerjes. Në pikën 1, të kësaj Guide jepet informacion mbi orientimin e personave me aftësi të kufizuara në Stadiumin “Air Albania”, si vijon:

“11 – Informacion rreth personave me aftësi të kufizuara

Vendet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara janë të pozicionuara në sektorin S & N. Hyrja e tyre e dedikuar është e pozicionuar në porta Jugore ‘S’. Individët me aftësi të kufizuara ose organizatat të cilat përfaqësojnë individët me aftësi të kufizuara mund të dërgojnë AFF listën e personave me aftësi të kufizuara, të cilët dëshirojnë të ndjekin ndeshjen Së bashku me shoqëruesit e tyre. Biletat për personat me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre janë pa pagesë. Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni me info@fshf.al”

Në vijim, KMD bëri kërkime edhe në faqen zyrtare *on line* të FSHF. Nga kërkimi rezultoi se në këtë faqe zyrtare gjendej seksioni i Biletarisë *on line* për aktivitetet që zhvillohen në stadiumin “Air Albania”. Në këto kushte, KMD pati akses në faqen e Biletarisë *on line* të

⁵ <https://bileta.t-ticket.al/biglietteria/pub/buyseats/scegliSettorePub.do?idEvento=923>

FSHF-së, ku sërisht ishte publikuar “Guida e Blerjes”, e cila kishte të njëjtin parashikim në pikën 11 të saj.

Përveç konstatimit të drejtpërdrejtë të KMD-së, akti “*Guida e Blerjes*” është dërguar edhe bashkëlidhur shkresës zyrtare të FSHF-së në adresë të KMD-së.

Komisioneri gjykon se nga analiza e sipërcituar, stadiumi ““Air Albania” ” i plotëson kriteret për aksesueshmërinë fizike të personave para-tetraplegjikë, si dhe referuar “Guidës së Blerjes” orientimi i këtyre personave kryhet në mënyrë korrekte.

Por, pavarësisht sa më sipër KMD gjykon se mungesa e informimit të ankueses gjatë procesit të prenotimit të biletës, ka shkaktuar situatën konkrete, që është objekt i kësaj ankese. Pavarësisht informacionit ekzistues nën Rubrikën “Guida e Blerjes”, KMD gjykon se vendosja e një emërtese më të qartë, do të kishte qënë e përshtatshme dhe orientuese për ankuesen, në mënyrë që të evitohet situata e ndodhur dhe znj. S.L. të kishte kryer prenotimin e saj, në tribunat, ku ofrohen vende për persona me aftësi të kufizuar. Referuar biletës së ankueses rezulton se ajo është prenotuar në një tribunë, ku nuk sigurohet akses për persona me aftësi të kufizuar, fakt që dëshmon se ka munguar informimi i përshtatshëm dhe efektiv. Për sa më sipër, KMD gjykon se pavarësisht se Stadiumi “Air Albania” i plotëson kriteret e aksesueshmërisë fizike për personat me aftësi të kufizuar, mënyra e organizimit të një eventit dhe marrja e masave specifike nga ana e organizatorëve, për të ofruar shërbimin e duhur ndaj personave me aftësi të kufizuar, është moment, të cilit i duhet kushtuar tepër rëndësi. Në rastin konkret, KMD çmon se ka munguar marrja e masave të mjaftueshme në këtë drejtim.

Nga analiza e provave të administruara, Komisioneri gjykon se Bashkia Tiranë dhe Federata Shqiptare e Futbollit nuk e kanë ekspozuar palën ankuese ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, por pavarësisht kësaj KMD jep rekomandimet e mëposhtëme për mangësitë e konstatuara.

Në mungesë të trajtimit të sipërcituar, nuk ekziston diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar të ankueses nga subjektet e sipërcituara.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. S.L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit.
- 2.** Rekomandohet që udhëzuesi për personat me aftësi të kufizuara, në Stadiumin “Air Albania”, i publikuar në faqen zyrtare të Federatës Shqiptare të Futbollit, si dhe në faqen BliniBileta.com, të jetë i thjeshtë, i dukshëm, lehtësisht i aksesueshëm, si dhe të ketë emërtesë të ngjashme dhe orientuese, për personat me aftësi të kufizuar.
- 3.** Rekomandohet që udhëzuesi që përmban rregulla akomodimi dhe orientuese për personat me aftësi të kufizuara, i publikuar në faqet e sipërcituara, të jetë gjithëpërfshirës edhe për grupet e tjera të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.
- 4.** Rekomandohet që Federata Shqiptare e Futbollit, për çdo lloj eventit që do të kryhet në të ardhmen në stadiumin “Air Albania”, të marrë masa specifike për informimin e duhur të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar mbi akomodimin e tyre në stadium, si dhe të marrë të gjithë masat e nevojshme organizative, me qëllim ofrimin e shërbimit të duhur, për realizimin e aksesueshmërisë së ambienteve të këtij stadium për këtë kategori individësh.
- 5.** Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Federata Shqiptare e Futbollit të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
- 6.** Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha- Të mira e shërbime
Shkak – aftësi e kufizuar
Lloji i vendimit - mosdiskriminim